

muhabetit. "Për Zorin", më thotë plaka, "muar me më arih meku ke dera s' mun me e lam me cofë përjashia kullës s' emel!" Këto e tërjera lline gruaja bravare me një zë të fortë e imponant.

Nuset po rinin më këmbë, vajza e vogël që pamë më natë ndënji afër zonjës t'onë dhe po nënqeshte gjithmonë, dhe fëmijët e djalit të plakës u shtruan afër gjyshes e cila s'i gëzonte dot...

Pas ca minuta arrijti prej bjeshke nipi i plakës — burr'i shiëpisë — dhe zuri këndin ku rinte ajo vetë. Ndonëse po bënte protestime që nuk e kishin zakon të zinin këndin e mikut, ne e vumë plakën të rijë në këndin e dytë.

Burri atëhere nxori kutinë edhe na dha të dredhim nga një cingare. Gjithpo n'atë kohë filloj të na pjekë edhe kafe. S' kish sheqer nga shkaku se i qe mbaruar dhe dugaja qe shumë lark prej Blinishtit. Pa Amerikaneja i propozoj të shoqt që t'i japë një sasi të mirë nga provizjonet t'ona. I thashë plakës të na sjellë një kutti, dhe u kënaq fort kur pa se ja mbushmë plot. "Tash," më tha, "plaka ka sheqer boll për me pij kafe!"

Passi pimë kafën, plaka u foli nuseve që të sjellin rakinë me ca djathë të bardhë. Pime sa muntmë edhe pastaj hapmë një shishe me konjak; këtë e ndamë andej këtej në për gra-